



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
S-022
Prishtinë, më 6, 7, 8 dhe 14 maj 2015

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 6, 7, 8 DHE 14 MAJ 2015

Seancën e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmuan Xhavit HALITI dhe Sabri HAMITI, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare dhe procedoi me pikat si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Bekim Haxhiu, Naser Osmani, Glauk Konjufca, Bali Muharremaj, Valdete Bajrami, Azem Sylja, Aida Dërguti, Zafir Berisha dhe ministrja Edita Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti, Elmi Reçica parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me masat konkrete të Ministrisë që ai drejton, për jetësimin e projektit “Lepenci” si pjesë e tërësishme e Projektit “Ibër-Lepenci”, për furnizim me ujë të pijes për 500 mijë banorë, si dhe zhvillimin ekonomik dhe bujqësor të Ferizajt me regjion.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Elmi Reçica.

Deputeti Armend Zemaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me masat preventive të ndërmarra nga Ministria që ai drejton lidhur me çështjen e shkatërrimit të ambientit në Grykën e Deçanit.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Armend Zemaj.

Deputetja Njomza Emini parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me planin konkret të Ministrisë që ai drejton lidhur me vendosjen e rendit të bizneseve eksploatuese të rërës në lumenjtë e Kosovës, në mënyrë që të arrijë të ruaj mjedisin dhe biodiversitetin.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Njomza Emini.

Deputetja Shqipe Pantina parashtroi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar në lidhje me atë se cilat janë institucionet që ende janë të vendosura në ndërtesa private dhe sa është shuma totale që paguhet nga buxheti i shtetit për marrjen me qira të këtyre ndërtesave.

Ministri Mahir Yagcilar, iu përgjigj pyetjes së deputetes Shqipe Pantina.

Deputetja Shqipe Pantina parashtroi pyetje për ministrin, Hajredin Kuçi në lidhje me të dhënat që i ka mbledhur Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë dhe sa kallëzime penale janë ngritur kundër forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe të cilat i kanë kryer këto krime, në gjykata të rregullta, si dhe cili ka qenë bashkëpunimi i këtij Instituti me Tribunalin e Hagës.

Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe a ka ndonjë plan konkret për pastrimin dhe zgjerimin e shtratit të lumit Morava.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputetja Besa Baftija parashtroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me atë se, cilat janë ato çështje të ngutshme për të cilat u dakorduat të bisedoni me kryeministrin serb Vuçiq.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Salihe Mustafa parashtroi pyetje për ministrin Lutfi Zharku në lidhje me procedurat e zhvilluara për realizimin e projektit të ardhshëm të autostradës Prishtinë – Gjiilan – Dheu i Bardhë.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetes Salihe Mustafa.

Deputeti Nezir Çoçaj parashtroi pyetje për ministrin Skender Hyseni në lidhje me ekzistimin e ndonjë plani operativ për parandalimin e dukurisë së vjedhjeve dhe plaçkitjeve që po bëhen ndaj qytetarëve, në komunat: Prizren, Gjakovë dhe Therandë.

Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Shukrije Bytyqi parashtroi pyetje për ministrin Arban Abrashi në lidhje me zbatimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit Drejtues të Forumit Kosovar për Aftësi të Kufizuara dhe Ministrisë që ai e drejton.

Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Selvije Halimi parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me vërtetimin e gjendjes reale dhe evitimit të parregullsive gjatë procesit të sistemimit të mësimdhënësve të cilët kanë mbetur pa normë me rastin e shuarjes së klasës së 13, në vitin shkollor 2014-2015, në komunën e Lipjanit.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Selvije Halimi.

Deputeti Nezir Çoçaj, parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me të dhënat për punësimin e pedagogëve dhe psikologëve në shkolla dhe angazhimin e Ministrisë që ai drejton në punësimin e tyre, në të ardhmen.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Nezir Çoçaj.

Deputetja Njomza Emini parashtoi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me buxhetin e ndarë nga Ministria e Shëndetësisë për financimin e shkollimit të specialistëve, sa është numri i tyre dhe cila është zgjidhja e mundshme për specialistët që kanë fituar specializimet e që kanë mbetur jashtë financimit, të cilët punojnë në institucionet shëndetësore publike. Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Njomza Emini.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtoi pyetje për ministrin Imet Rrahmani, në lidhje me hapat konkret që do të merren në aktivizimin e Njesisë së Kardio-Kirurgjisë. Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Shukrije Bytyqi tha se pasi pyetja e saj për ministrin Imet Rrahmani është e lëmisë së njëjtë me pyetjen paraprake të deputetes Time Kadrijaj, atëherë konsideroj se përgjigjja në këtë pyetje është dhënë.

Deputeti Mytaher Haskuka parashtoi pyetje për ministren, Hykmete Bajrami në lidhje me importin e automjeteve dhe bllokimin e veturave në dogana me muaj të tërë, për qytetarët e verbër. Pse nuk aplikohen dispozitat ligjore për këtë grup të cenuar të popullatës. Ministria Hykmete Bajrami nuk ishte e pranishme në sallë.

Deputeti Mytaher Haskuka parashtoi pyetje për ministrin Kujtim Shala në lidhje me atë se çfarë është duke bërë Ministria që ai drejton për parandalimin e degradimit të historisë dhe trashëgimisë kulturore në Kosovë si dhe për hapat konkret për të shpëtuar objektin e shkollës së mesme “Ryzhdije” nga shkatërrimi total që po ia bën komuna e Prizrenit. Ministri Kujtim Shala, iu përgjigj pyetjes së deputetit Mytaher Haskuka. Në këtë pyetje, përgjigje dha edhe ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ferid Agani.

Deputeti Shaip Muja parashtoi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me arsyet objektive pse nuk mund në QKUK të funksionojë Kardiokirurgjia, sa është investuar deri më tani në këtë sistem dhe sa planifikohet të investohet dhe pse qasja e kardiologëve është skeptike në funksionalizimin e Qendrës së Kardiokirurgjisë. Sa i besoni programit qeveritar për zhvillimin e shëndetësisë dhe çka mendoni të bëni ndryshe nga ajo që është bërë para se ju të vini në pozitën aktuale. Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetit Shaip Muja.

Deputeti Shaip Muja, parashtoi pyetje për ministrin Skender Hyseni në lidhje me arsyet se pse studentët nga Kosova të cilët kanë përfunduar studimet në Akademinë Policore në Ankara, nuk sistemohen në Policinë e Kosovës dhe cili është qëndrimi zyrtar i drejtuesve të saj dhe i Inspektoratit Policor lidhur me, siç tha ai shkeljet që janë bërë në këtë drejtim. Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Besa Baftiu parashtoi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me, siç tha ajo, mbylljen e Kardiokirurgjisë në QKUK. Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Besa Baftiu.

* * *

Në vazhdim, lidhur me rendin e ditës, fjalën e kërkoi zv/kryeministri, Kujtim Shala.

Kujtim Shala, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, tha se i tërheq nga procedura parlamentare dy projektligjet e propozuara për rendin e ditës së seancës së sotme - Projektligjin për trashëgiminë kulturore dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Gjithashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës, tërheq nga procedura parlamentare - Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Zv/kryeministri propozoi që pika e propozuar nr. 6 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë të shqyrtohet në vazhdimin e seancës më 7 maj 2015.

Kuvendi nëpërmjet një votimi formal miratoi propozimin e lartpërmendur, në lidhje me shqyrtimin e pikës nr. 6.

Në lidhje me deklarinë e zv/kryeministrit, Kujtim Shala, diskutuan deputetët: Albulena Haxhiu, Arben Gashi, Glauk Konjufca, Vjosa Osmani, Bekim Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami, Armend Zemaj, Ilir Deda dhe Ismet Beqiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kuvendi nëpërmjet një votimi formal miratoi propozimin e lartpërmendur, në lidhje me shqyrtimin e pikës nr. 6.

* * *

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA,
5. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armë,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për letërnjoftim,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokatin e Popullit,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për barazi gjinore,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga diskriminimi,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trashëgiminë kulturore,

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore (*debati ka përfunduar në seancën e mëparshme*),
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore,
17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose Panelit për Lirim me Kusht,
18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
19. Emërimi i shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor,
20. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin e qytetarëve të Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit,
21. Rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike,
22. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e arsimit në Luginën e Preshevës, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, mbështetur edhe nga gjashtë (6) deputetë tjerë,
23. Shqyrtimi i raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2014,
24. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2014,
25. Shqyrtimi i raportit të auditimit për vitin 2013 të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm,
26. Shqyrtimi i raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2014,
27. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014,
28. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2014,
29. Shqyrtimi i raportit financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014,
30. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social,
31. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja,
32. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

* * *

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 16 prill 2015.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë këtë projektligj.

Ministri Mahir Yagcilar tha se Qeveria e Republikës së Kosovës është mbështetëse e qëllimit themelor të politikës së FATCA-së për të përmirësuar pajtueshmërinë e tatimeve në nivel ndërkombëtar, e cila synon luftimin e evazionit fiskal në SHBA.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen në tërësi të projektligjit dhe ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA.

Fjala e ministrit Mahir Yagcilar është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së lartpërmendur.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji e paraqiti deputeti Naser Osmani.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Safete Hadërgjonaj - në emër të GP të PDK-së, Naser Osmani - në emër të GP të LDK-së, Ilir Deda - në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Teuta Haxhiu - në emër të GP të AAK-së, Bali Muharremaj - në emër të GP të AAK-së, Valdete Bajrami - në emër të GP NISMA, Sasha Milosavljeviq - në emër të GP LS dhe Qerim Bajrami - në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku, 80 vota “për”, dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Më pas, kryetari hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 80,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet ligji nr.05/L-13 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA.

2. Ligji i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës, për shpallje.

5. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Kryetari i informoi deputetët se Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar listën e kandidatëve për anëtarë të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, të propozuar nga Qeveria dhe Kuvendit i ka rekomanduar emërimin e katër (4) nga tetë (8) të propozuarit për anëtarë të këtij bordi.

Deputeti Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit funksional, paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve të Kuvendit raportin me rekomandime.

Ai theksoi se në pajtim me ligjin nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale janë propozuar kandidatët, si në vijim:

1. Musa Shabani,
2. Festim Kutlllovci,
3. Selim Frangu,
4. Avdi Konjuhi,
5. Kemajl Zeqiri,
6. Shpend Tërdeva,
7. Bekim Troni dhe
8. Azem Rexhaj.

Më tutje, kryetari theksoi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës, dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Hajdar Beqa,
2. GP LDK - Blerim Grainca,
3. GP Vetëvendosje – Besa Baftiu,
4. GP AAK - Pal Lekaj,
5. GP - LS - Jelena Bontiq,
6. GP - “Nisma” - Shukrije Bytyqi,
7. GP – “6+” - Qerim Bajrami.

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti deputeti Hajdar Beqa. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 92 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 2 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

1. Musa Shabani ka fituar 53 vota
2. Festim Kutlllovci ka fituar 53 vota
3. Selim Frangu ka fituar 26 vota
4. Avdi Konjuhi ka fituar 30 vota
5. Kemajl Zeqiri ka fituar 33 vota
6. Shpend Tërdeva ka fituar 42 vota
7. Bekim Troni ka fituar 22 vota
8. Azem Rexhaj ka fituar 38 vota.

Hajdar Beqa, konstatoi se kandidati Musa Shabani dhe Festim Kutlllovci, zgjedhen anëtarë të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Në rundin e dytë të votimit hyjnë katër kandidatët me numër më të madh votash:

1. Avdi Konjuhi,
2. Kemajl Zeqiri,

3. Shpend Tërdeva,
4. Azem Rexhaj,

Ndërsa, nga lista e fletëvotimit hiqen emrat e dy kandidatëve me më së paku vota, si në vijim:
Selim Frangu dhe
Bekim Troni.

Rundi i dytë i votimit

Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Hajdar Beqa. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 87 deputetë.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

1. Avdi Konjuhi ka fituar 27 vota
2. Kemajl Zeqiri ka fituar 44 vota
3. Shpend Tërdeva ka fituar 26 vota
4. Azem Rexhaj ka fituar 35 vota.

Hajdar Beqa, konstatoi se kandidati Kemajl Zeqiri, zgjedhet anëtar i Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Në rundin e dytë të votimit hyjnë dy kandidatët me numër më të madh votash:

1. Avdi Konjuhi dhe
2. Azem Rexhaj.

Ndërsa, nga lista e fletëvotimit hiqet emri i kandidatit me më së paku vota, Shpend Tërdeva.

Rundi i tretë i votimit

Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues raportin e paraqiti Hajdar Beqa. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 75 deputetë. Të pavlefshme janë 3 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

1. Avdi Konjuhi ka fituar 34 vota
2. Azem Rexhaj ka fituar 38 vota.

Hajdar Beqa, konstatoi se kandidati Azem Rexhaj, zgjedhet anëtar i Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Emërohen anëtarët e Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, si në vijim:

1. Musa Shabani, kryesues
2. Festim Kutllovci, anëtar

3. Kemajl Zeqiri, anëtar dhe
4. Azem Rexhaj, anëtar.

II. Mandati i të emëruarve nga pika nr. I. e këtij vendimi është pesë (5) vjet.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës

Kryesuesi Xhavit Haliti e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

Ministri **Mahir Yagcilar** tha se ky projektligj ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës. Në këtë projektligj Dita e Evropës nuk do të jetë ditë pushimi siç përcaktohet me ligjin në fuqi, ndërsa parashihet që Qeveria me në rastet e veçanta, me vendim të caktojë ditët e pushimit për administratën shtetërore.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Mahir Yagcilar, është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Zenun Pajaziti - në emër të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Xhevahire Izmaqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Melihate Tërmmkolli - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Shqipe Pantina - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Pal Lekaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zafir Berisha - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Qerim Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe, Flora Brovina, Rexhep Selimi, Raif Qela, Muhamet Mustafa, Albin Kurti, Emilija Rexhepi, Blerta Deliu-Kodra, Melihate Tërmmkolli, Bekim Haxhiu, Sala Berisha-Shala, Ismajl Kurteshi, Hajdar Beqa, Nait Hasani, Gëzim Kelmendi, Ganimete Musliu, Sabri Hamiti dhe ministri Mahir Yagcilar, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi Sabri Hamiti, konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim, ashtu siç kërkohet në bazë të nenit 81, amendamentit 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Procedimi me votim do të bëhet në vazhdim të seancës.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri

Kryesuesi Sabri Hamiti e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri.

Ministri **Imet Rrahmani** tha se me këtë projektligj, përpos institucioneve të parapara me ligjin në fuqi, do të përfshihet edhe Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe Agjencia e

Kosovës për Forenzikë, me qëllim të pajisë me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Imet Rrahmani, është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Nuredin Ibishi - në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fadil Demaku - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Rexhep Selimi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zafir Berisha - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Qerim Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,

Kundër ----- 0,

Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armë

Kryesuesi Sabri Hamiti, e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për armë.

Ministri **Imet Rrahmani**, tha se ky projektligj rregullon kushtet për blerjen, posedimin, armëmbajtjen, ruajtjen, prodhimin, çaktivizimin, riparimin, importimin, transitin, shitjen , transportimin dhe shënjimin e armëve dhe municionit për personat fizik dhe juridik, brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe eksportimin nga Republika e Kosovës, të destinuar vetëm për përdorim civil.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Imet Rrahmani, është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Rexhep Selimi - në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Fadil Demaku - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Nuredin Ibishi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zafir Berisha – diskutoi në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Qerim Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Bekim Haxhiu dhe Ganimete Musliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim për këtë projektligj.

Procedimi me votim do të bëhet në vazhdim të seancës.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për letërnjoftim

Kryesuesi Sabri Hamiti e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për armë.

Ministri **Imet Rrahmani** tha se ky projektligj përcakton kushtet, procedurat dhe organin kompetent për lëshimin dhe përdorimin e letërnjoftimit nga shtetasit e Republikës së Kosovës. Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Imet Rrahmani është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Fadil Demaku - në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ganimete Musliu - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ali Sadriu - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Qerim Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Milazim Haliti, Nait Hasani dhe Emilija Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi, konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim për këtë projektligj.

Procedimi me votim do të bëhet në vazhdim të seancës.

Kryesuesi përfundoi punimet e seancës për ditën e sotme, ndërsa vazhdimi i kësaj seance do të bëhet më 7 maj 2015, në orën 10.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës së sotme, në orën 19 e 10 minuta.

* * *

7 maj 2015, ora 10:00

Vazhdimi i seancës, e filluar më 6 maj 2015

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të seancës plenare të filluar më 6 maj 2015.

Kryetari para se të fillojë me pikat e rendit të ditës i dëshiroi mirëseardhje në Kosovë, delegacionit nga SHBA-të, në krye me ish-kongresistin Pomeroy, të cilët ishin të pranishëm në sallë.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditës si në vijim:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Kryetari tha se ky projektligj është propozuar nga Nisma Qytetare – Drejtësia dhe Qytetarët. Qeveria e Kosovës nuk i ka dërguar Kuvendit mendimin lidhur me këtë projektligj.

Më pas, ai ftoi deputeten Vjosa Osmani, e autorizuar nga propozuesi, që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

Vjosa Osmani tha se këtë projektligj e paraqet në Kuvend në emër të 13 000 qytetarëve që janë nënshkruar në këtë nismë legislative për ta ndryshuar një nen të Ligjit për menaxhimin e financave publike.

Në pajtim me Kushtetutën e Kosovës, përkatësisht nenin 79 të Kushtetutës, si dhe Ligjin për nisma legislative, nëpërmjet kësaj nisme, kampanja ‘drejtësia dhe qytetarët’, kanë propozuar amendamentimin e nenit 69 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë për të lejuar kompensimin e dëmeve joekonomike për viktimat e shkeljeve të drejtave të njeriut.

Nëpërmjet këtij ndryshimi synohet që ky ligj të jetë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të rrisë përgjegjësinë e zyrtarëve publikë në respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe të rrisë besueshmërinë e qytetarëve të Kosovës ndaj institucioneve publike. Të gjitha këto çështje që pothuajse çdo vit paraqiten si sfida në Raportin e Progresit, të përgatitur nga Komisioni Evropian për Kosovën.

Sa i përket nenit 69, që sot po propozohet të amendamentohet nga qytetarët e Kosovës, ky nen përcakton se dëmet e lejueshme të institucioneve publike që mund t’u ofrojnë qytetarëve janë si vijon: Gjykata kompetente është e autorizuar që ta urdhërojë një autoritet publik ose organizatë buxhetore që të paguajë kompensim monetar vetëm për dëme të drejtpërdrejta ekonomike, të cilat janë vërtetuar nga gjykata, në bazë të provave.

Pra, ky nen e ndalon kompensimin e dëmeve joekonomike, ku përfshihen dëmet që lidhen me dhimbjet, vuajtjet dhe hidhërimin, si pasojë e shkeljes së të drejtave të njeriut.

Për më tepër, kjo është në kundërshtim edhe me Kushtetutën e Kosovës, si dhe me detyrimet e Kosovës si shtet karshi të drejtës ndërkombëtare.

Kushtetuta e Kosovës i njeh të drejtat e qytetarëve që të kërkojnë mbrojtje të drejtave të njeriut nëpërmjet autoriteteve gjyqësore, si dhe të kenë qasje në mjete efektive juridike në rast se këto të drejta shkelen. Pra, të dyja këto të përfshira në Kapitullin II të Kushtetutës.

Në vazhdim ajo foli në detaje për arsyeshmërinë e ndryshimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e znj. Vjosa Osmani. është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Naser Osmani - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonaj - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ilir Deda - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Bali Muharremaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Enver Hoti - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, si dhe Faton Topalli, Shqipe Pantina dhe ministri Avdullah Hoti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 74,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Votimi në parim i Projektligjit për armë

Kryetari tha se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën e mbajtur me 6 maj 2015, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim do të bëhet sot.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për armë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 79,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për armë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Votimi në parim i Projektligjit për letërnjoftim

Kryetari tha se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 6 maj 2015, mirëpo në mungesë të kuoromit, procedimi me votim do të bëhet sot.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për letërnjoftim.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 78,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për letërnjoftim.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokatin e Popullit

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Avokatin e Popullit.

Ministri **Arban Abrashi** tha se ky projektligj ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrje dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave të cilët ushtrojnë autorizime publike në vend, si dhe krijimin e mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Arban Abrashi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Lirije Kajtazi - në emër të Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Mexhide Mjaku-Topalli - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Mytaher Haskuka - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Valdete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Kujtim Paçaku - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Salihe Mustafa, Sabri Hamiti dhe Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi Xhavit Haliti e hodhi në votim Projektligjin për Avokatin e Popullit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 12,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Avokatin e Popullit. Kuvendi ngarkoi Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës

Kryesuesi Xhavit Haliti tha se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 6 maj 2015, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim do të bëhet sot.

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 50,
Kundër ----- 20,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Nuk miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-16 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për barazi gjinore

Kryesuesi Xhavit Haliti e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Barazi Gjinore.

Ministri **Arban Abrashi** tha se ky projektligj garanton, mbron dhe promovon barazinë ndërmjet gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.

Projektligji përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të barabarta të grave dhe burrave, si dhe përcakton institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Arban Abrashi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Lirije Kajtazi - në emër të Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Salihe Mustafa - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Aida Dërguti - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Valdete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Kujtim Paçaku - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Blerta Deliu-Kodra,

Melihate Tërmmkolli, Faton Topalli, Gëzim Kelmendi, Sala Berisha-Shala, Emilija Rexhepi, Nuredin Ibishi, Glauk Konjufca dhe Shaip Muja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Barazi Gjinore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 65,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Barazi Gjinore.

Kuvendi ngarkoi Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga diskriminimi

Kryesuesi Xhavit Haliti e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për mbrojtje nga diskriminimi.

Ministri **Arban Abrashi** tha se qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar etj ose ndonjë baze tjetër të përcaktuar me ligj apo marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare në fuqi, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Arban Abrashi, është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Mexhide Mjaku-Topalli - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Etem Arifi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Shukrije Bytyqi - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, si dhe Teuta Sahatqija, Emilija Rexhepi, Shaip Muja, Zenun Pajaziti, Blerta Deliu-Kodra, Daut Haradinaj dhe Ministri Arsim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për mbrojtje nga diskriminimi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mbrojtje nga diskriminimi.

Kuvendi ngarkoi Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e maturës shtetërore

Kryesuesi tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 16 prill 2015.

Ndërsa, në mungesë të kuorumit procedimi me votim, është shtyre për sot.

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për provimin e maturës shtetërore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për provimin e maturës shtetërore.

Kuvendi ngarkoi Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore

Kryesuesi Xhavit Haliti e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore.

Ministri **Arban Abrashi**, tha se ky Projektligj rregullon procesin kalues nga emetimi analog në atë digjital në Republikën e Kosovës, i cili sipas konkluzioneve të Konferencës Rajonale Radio-komunikuese të ITU-së do të duhej të përfundonte deri më 17 qershor 2015

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Arban Abrashi, është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij Projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa - në emër të Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti - në emër të Komisioni funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Sala Berisha-Shala - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Sadri Ferati - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes

“Vetëvendosje”; Pal Lekaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Enver Hoti - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Kujtim Paçaku - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Shqipe Pantina, Donika Kadaç-Bujupi, Xhevahire Izmaç dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 42,
Kundër ----- 22,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për digjitalizimin e transmetimeve radio- difuzive.

Kuvendi ngarkoi Komisioni për zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose Panelit për Lirim me Kusht

Kryesuesi Xhavit Haliti tha se Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit si dhe komisionet e përhershme, e kanë shqyrtuar Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose Panelit për Lirim me Kusht dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportin e Komisionit Funksional e paraqiti dhe e arsyetoi anëtari i këtij Komisioni, Armend Zemaj.

Diskutimi i deputetit Armend Zemaj është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose Panelit për Lirim me Kusht, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 66,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi ligjin nr. 05/L-03 për Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës.

17. Emërimi i shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Kryesuesi Xhavit Haliti tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 16 prill 2015.

Ndërsa, në mungesë të kuorumit procedimi me votim, është shtyrë për sot.

Kryesuesi më pas lexoi emrat e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, si në vijim:

1. Shafi Gashi - shqiptar,
2. Florim Isufi - shqiptar,
3. Arjete Miftari - shqiptare,
4. Doruntinë Matoshi - shqiptare,
5. Visar Haxhibeqiri - shqiptar,
6. Bego Kululleri - turk,
7. Filjko Jovanoviq - serb.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 54,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se për shkak të mungesës së pjesëmarrjes të deputetëve në procedurën e votimit, nuk miratohet emërimi i anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Kryesuesi theksoi se kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare duhet të sqarojnë arsyen e mungesës së pjesëmarrjes së deputetëve në procedurën e votimit.

18. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin e qytetarëve të Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit

Kryesuesi Xhavit Haliti tha se Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, e ka shqyrtuar peticionin për zbardhjen e fatit të Ukshin Hotit dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimet për miratim.

Ai ftoi deputeten Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të Komisionit FunkSIONAL të lartpërmendur që ta marrë fjalën.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se historia e zhdukjes së Ukshin Hotit mbetet e mistershme, njeriu që punoi shumë për filozofinë e çlirimit të Kosovës, i përndjekur vazhdimisht nga forcat jugosllave prej majit të vitit 1999 i ka humbur gjurmët.

Profesori njihet si intelektual, filozof e veprimtar. Thuhet se Ukshin Hoti ishte njëri ndër ata që e arkitekttoi lirinë e Kosovës. Për këtë arsye ishte gjithkund i vëzhguar. I lindur në vitin 1943, në Krushë të Madhe të Rahovecit, pas kryerjes së shkollës fillore dhe të mesme në Prizren dhe Prishtinë, u diplomua për shkenca politike në Zagreb. I etur për dije, të cilat do t'i

vinte më pas në funksion të çështjes kombëtare, u specializua edhe në Universitetin e Harvardit.

U kthye në Kosovë ku doli hapur me idetë e tij për një lëvizje për liri. Këtu do të fillonte kalvari i dhembjeve, i burgosjeve të njëpasnjëshme, duke e çuar deri në kufijtë e ekzistencës. Ukshin Hoti, i gjendur në skajim dramatik, herë në burg e herë në Krushë të Madhe, ngërthen thelbin dhe ankthin ekzistencial. Përtej caqeve mbetet shëmbëlltyra dhe vlera e filozofit balatesk që vendosi gurët e themelit për çështjen shqiptare. Mu në qendër të pamjes së Kosovës reagoi emocionalisht, doli kundër rrymës dhe me dokumente autentike nxori në sipërfaqe ndjenjat e popullit të Kosovës kundër pushtuesit serb.

Profesori i Universitetit të Prishtinës, Ukshin Hoti i mbrojti në Katedrën e Filozofisë demonstratat e studentëve në vitin 1981. Në këtë ditë e arrestoi shërbimi sekret i UDB-së jugosllave. Fillojnë torturat në burg. Pas disa vitesh burgim lirohet, nuk e pranojnë të japë mësim më në Universitet. Policia ia merr banesën dhe pa asnjë lek në xhep endet në gjendje dramatike në rrugët e Prishtinës.

E vetmja strehë e tij bëhet fshati i lindjes Krusha e Madhe, ku jetonte bashkë me babanë Nazifin, që ishte gazetashitës, dhe nënën Fatime, që ishte shtëpiake. Me atë që kam hulumtuar, edhe në këtë gjendje gati të izoluar forcat e UDB-së e ndiqnin edhe në kopshtin e perimeve, aty ku ai lexonte Niçen dhe u jepte mësim studentëve që vinin ta takonin fshehtas.

Nuk hoqi dorë nga mendimi i tij filozofik për çlirimin e Kosovës. Vitet e tëra do t'i shpenzojë me punë ilegale nëpër bjeshkën e Celinës, çosh më çosh me militantët e ardhshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë edhe komandantin legjendar, Adem Jashari.

Arrestimi i tij i dytë u bë në mars të vitit 1993, sepse një vit më parë e kishte organizuar një homazh masiv për martirët e demokracisë në Brestofc. Për herë të tretë dënohet më 17 maj 1994, kur shkon në Pallatin e Shtypit në Prishtinë për ta vizituar grevën e urisë të Adem Demaçit. Një ditë para se ta përfundonte dënimin, Ukshin Hoti zhduket në mënyrë të mistershme.

Nëpërmjet dokumenteve të pakontestueshme mësohet se ditën e diel, në orën 10:00 të datës 16 maj 1999, drejtori i Burgut të Dubravës, afër Istogut, Aleksandër Rakoçeviq, e nxjerr nga burgu filozofin e Krushës, Ukshin Hotin. Këtë e pranon madje edhe vetë Rakoçeviq.

Në atë që më vijnë disa pyetje, përse drejtori e ka nxjerrë nga burgu Ukshin Hotin ditën e diel, kur nuk punonte fare administrata. Kush e urdhëroi ta shkelë ligjin? Përse drejtori i burgut nuk ia ka kontrolluar fare librat, dokumentet që ka pasur në qeli Ukshin Hoti? Cilët qenë ata që e prisnin në makinë para burgut të Istogut? Kush e shoqëroi që nga qelia e gjer në makinën gri, me civilë brenda?

Pas bombardimeve të NATO-s, më 19 maj 1999, në Burgun e Dubravës ka ndodhur masakra më e përgjakshme. Janë ekzekutuar e masakruar 173 të burgosur shqiptarë nga forcat serbe.

Peticioni i nënshkruar nga qytetarët e Rahovecit, përmban rreth 13 mijë nënshkrime. Komisioni, duke vepruar sipas peticionit, i ka dëgjuar përfaqësuesit e peticionit, përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur dhe përfaqësuesit e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me zbardhjen e fatit të magjistër Ukshin Hotit dhe të gjithë të zhdukurve të tjerë i propozon Kuvendit miratimin e rekomandimeve, si në vijim:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës në bisedimet Kosovë-Serbi të kërkojë që brenda gjashtë muajve të përfshihet në agjendën e bisedimeve zbardhja e fatit të personave të pagjetur dhe me raportin për rezultate dhe sfidat në këtë proces të njoftohet Kuvendi i Republikës së Kosovës.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës të sigurojë fonde për funksionalizimin e mekanizmave përkatës profesional teknik për punë më efektive për identifikimin e mjeteve mortore dhe për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.
3. Subjektet bartëse të politikës ndërparlamentare dhe politikës së jashtme të Kosovës në agjendat e takimeve me përfaqësuesit e OKB-së, BE-së dhe të shteteve me ndikim në marrëdhëniet ndërkombëtare të fokusohen në mënyrë të veçantë dhe me prioritet zbardhjen e fatit të personave të pagjetur në dritën e zbatimit të këtyre rekomandimeve dhe për këtë ta njoftojmë Kuvendin e Republikës së Kosovës në baza gjashtëmujore.

Të gjithë bartësit e detyrave, sipas këtyre rekomandimeve, t'i qasen në mënyrë të veçantë zbardhjes të fatit të magjistër Ukshin Hotit për shkak të rrethanave të zhdukjes së tij të planifikuar nga strukturat komanduese ushtarake-policore të shtetit serb dhe Drejtoria e Burgut të Dubravës, në Istog.

Andaj ne si Komision ju ftojmë që t'i miratoni këto rekomandime të dala nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe të Pagjeturit.

Diskutimi i deputetes Mexhide Mjaku-Topalli është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Mexhide Mjaku-Topalli- në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lirije Kajtazi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Glauk Konjufca - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Daut Haradinaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Valdete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, si dhe, Adem Grabovci, Armend Zemaj, Teuta Haxhiu, Zafir Berisha, Salihe Mustafa, Shaip Muja, Time Kadrijaj, Gëzim Kelmendi, Flora Brovina, Visar Ymeri, Luljeta Veselaj-Gutaj, Blerta Deliu-Kodra, Nait Hasani, ministri Arsim Bajrami dhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, deputeti Glauk Konjufca propozoi që të bëhet harmonizimi i propozim-rekomandimeve me Rezolutën e miratuar për këtë çështje më 15 maj 2012

Më pas kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli propozoi që propozim-rekomandimet e paraqitura nga Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, të harmonizohen me të gjitha grupet parlamentare.

Në lidhje me këtë propozim të kryetarit të Kuvendit u deklaruan deputetët, si në vijim: Lirije Kajtazi , në emër të Komisionit Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Glauk Konjufca - në emër të

Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Valdete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, si dhe, Shaip Muja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari konstatoi se Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, më 8 maj 2015, në orën 9 të mbajë mbledhje me përfaqësues të grupeve parlamentare për harmonizimin e propozim rekomandimeve

Kuvendi u pajtua me propozimin e lartpërmendur.

Kryetari, konstatoi se Kuvendi përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa vazhdimi i seancës do të bëhet nesër më 8 maj 2015 në orën 10.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 17:58 minuta.

8 maj 2015, ora 10:00

Vazhdimi i seancës, e filluar më 6 dhe e vazhduar më 7 maj 2015

Seancën e drejtoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Nënkryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të seancës plenare të filluar më 6 maj 2015.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditës si në vijim:

19. Rekomandimet e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike

Nënkryetari tha se Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, e ka shqyrtuar Peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike, të parashtruar nga Koalicioni i qytetarëve konsumatorë, sindikatat dhe organizatat joqeveritare dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime, të harmonizuara me Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Ai ftoi deputeten Lirije Kajtazi, në emër të Komisionit FunkSIONAL të lartpërmendur, që ta marrë fjalën.

Lirije Kajtazi tha se sot para vetes kemi një peticion të madh, si për nga numri i nënshkruesve, i cili sipas propozuesit është nënshkruar nga 32 276 qytetarë, po ashtu i madh edhe për nga lënda që e trajton kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike.

Peticioni është parashtruar nga koalicioni i qytetarëve konsumatorë, sindikatat dhe organizatat joqeveritare me këtë përmbajtje, që nëpërmjet një rezolute t'i anulojë vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë të datës 29 gusht 2014. Këto janë materiale të bashkangjitura, të cilat janë pjesë e peticionit, të amendamentohet ligji numër 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar, ku do largohej TVSH-ja prej 16% nga faturat e energjisë elektrike.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, me pajtim të parashtruesve të peticionit, peticionin e ka trajtuar në Komision si peticion në formë të ankesës kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike.

Mbi këtë bazë, duke vepruar sipas kompetencës, janë dëgjuar dëshmitë e parashtruesve të peticionit dhe dëshmitë e përfaqësuesve të ZRRE-së dhe janë nxjerr rekomandimet e Komisionit siç kanë dalë, e keni parë më herët. Meqenëse kanë ndikim buxhetor këto janë trajtuar edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe ka qenë një nga arsyet që është hyrë që të harmonizohen rekomandimet e të dy komisioneve, atij të Drejtave të Njeriut dhe të Buxhetit e të Financave dhe kemi konsideruar se do të jetë e rëndësishme për deputetët që ta kenë në dorë raportin e Zyrës së Rregullatorit, i cili do të japë shumë informata që deputetët të mos kenë sot qasje politike, por ta kenë një trajtim të drejtë të gjithë ecurisë së kësaj pune dhe, mbi të gjitha, ju do ta keni aty edhe një material shtesë, të cilin Komisioni FunkSIONAL e ka trajtuar. E dini që pika 28 e seancës e ka raportin e Zyrës, e ka trajtuar Komisioni FunkSIONAL, ka kërkuar material shtesë të cilin ia ka ofruar Zyra e Rregullatorit dhe besoj është një bazë e mirë për ta trajtuar këtë pikë dhe një informacion shumë më i nevojshëm, i cili edhe e arsyeton shtyrjen, me gjithë deklaratimet e mëhershme për shtyrje të qëllimshme, apo gjëra të tjera.

Në vazhdim ajo paraqiti para Kuvendit rekomandimet e komisionit që janë të harmonizuara me Komisionin për Buxhet dhe Financa, si në vijim:

1. Zyra e Rregullatorit për Energji, në afat prej një muaji nga dita e miratimit të këtij rekomandimi t'ia paraqesë për njoftim Kuvendit të Republikës së Kosovës një raport të veçantë për të gjitha çështjet e paraqitura në peticion lidhur me dy rritjet e fundit të çmimit të energjisë elektrike, duke përfshirë edhe analizën e detajuar të çmimeve.
2. Qeveria, në afatin sa më të shpejtë, ta procedojë në Kuvend Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit numër 03/L-146 për tatimin në vlerën e shtuar dhe të propozohet zbritja e TVSH-së në konsumin e energjisë elektrike nga 16% në 8%.
3. Qeveria ta rishikojë listën e përfituesve të kategorive sociale dhe të identifikohen përfituesit që e kanë ndryshuar statusin financiar, që normalisht është në rregull, në mënyrë që të bëhet rishpërndarja e mjeteve buxhetore në emër të pagesës së energjisë elektrike për familjet që ende kanë nevojë dhe mundësisht edhe të shikohet mundësia për ngritje.
4. Të mos bëhet asnjë rritje e re e çmimeve të energjisë elektrike deri në rishikimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për 2015.

Në fund, ajo ftoi deputetët që pas debatit t'i miratojnë rekomandimet e Komisionit lidhur me peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike.

Diskutimi i deputetes Lirije Kajtazi është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Naser Osmani – në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Mexhide Mjaku-Topalli- në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes” Vetëvendosje”, Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Enver Hoti - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Kujtim Paçaku - në emër të Grupit Parlamentar 6+ si dhe, Ministri Avdullah Hoti, Glauk Konjufca, Selvije Halimi, Fatmir Rexhepi, Aliu Sadriu, Faton Topalli, Pal Lekaj, Zafir Berisha, Shpejtim Bulliqi, Mytaher Haskuka, Hajdar Beqa, Blerim Grainca, Besnik Bislimi, Zenun Pajaziti, Ismajl Kurteshi, Lirije Kajtazi dhe kryeministri Isa Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e propozim-rekomandimeve të Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike.

Të pranishëm në sallë ishin 65 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 42,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se për shkak të mungesës së pjesëmarrjes të deputetëve në procedurën e

votimit, nuk miratohen Propozim-rekomandimet e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike.

20. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e arsimit në Luginë të Preshevës, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, mbështetur edhe nga gjashtë (6) deputetë tjerë

Kryesuesi Xhavit Haliti, njoftoi se deputeti Nait Hasani dhe gjashtë deputetë tjerë nënshkruan, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me gjendjen e arsimit në Luginën e Preshevës (Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje).

Ai ftoi deputetin Nait Hasani, në cilësinë e propozuesit të çështjes, që ta paraqesë dhe arsyetojë në Kuvend, kërkesën për debat parlamentar.

Nait Hasani tha se Komisioni për Arsim, Teknologji, Kulturë, Shkencë, Sport dhe Diasporë e ka realizuar vizitën e parë të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Serbi në komunat shqiptare në Preshevë, në Bujanoc dhe Medvegje, më 9 dhe 10 mars 2015.

Në vizitën tonë, kemi realizuar takime me kryetarin e Këshillit Kombëtar Shqiptar, zotin Januz Musliu me kryetarët e komunave të Preshevës, Ragmi Mustafën, të Bujanocit, Nagip Arifin, dhe nënkryetarin e Komunës së Medvegjes, Florim Sahiti.

Komisioni i ka vizituar edhe disa shkolla në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes. Për ta realizuar këtë vizitë dua ta falënderoj edhe ambasadorin tonë në Beograd, Valdet Sadikun, që na mbështeti dhe ishte me ne në Luginën e Preshevës. Në këtë vizitë Komisioni ynë ka mësuar shumë për zhvillimet e arsimit dhe të kulturës në Luginën e Preshevës. Pamë dhe shkollat që ishin model i kuadrit profesional, si Gjumnazi “Skënderbeu”, Shkolla Teknike në Preshevë, shkolla fillore në Rincë, në Bujanoc, në Tërnoc, shkolla “Sezai Surroi”, “Muharrem Kadriu” me kuadro profesionale.

Po mësuam dhe nga mësuesit, nga kryetarët e komunave, nga nxënësit, nga arsimtarët se në Luginën e Preshevës gjendja në arsim dhe në kulturë është e rëndë. E rëndë është kjo gjendje nga fakti se shteti serb ende nuk është liruar nga mentaliteti i regjimit të Millosheviqit në shtypjen dhe asimilimin e shqiptarëve në këtë rajon. Asimilimi atje dhe shpërngulja është nga pjesa e ngjalljes së frikës me lëvizjet e xhandarmërisë, arrestimet e kohëpaskohshme të shqiptarëve nga ekspedita policore dhe ushtarake kinse për fajet e bëra në luftën e 2001 të ushtrisë çlirimtare Preshevë, Medvegje, Bujanoc.

Aty mësuam që në shkolla nuk ka libra të botuara në shqip që botohen në Republikën e Kosovës. Librat që janë botuar dhe janë dërguar në shkollat e Preshevës i ka konfiskuar xhandarmëria serbe. Prandaj, sot, në shekullin XXI, shteti serb nën vëzhgim të Brukselit i ka burgosur librat shqip.

Ajo ka tentuar ta burgosë Kosovën, por këtë nuk ka mundur ta arrijë dhe për këtë tashmë atje i ka burgosur si hakmarrje librat shqip, e ka burgosur abetaren shqip duke e tejkaluar edhe kohën e Mesjetës dhe kohën e Perandorisë Osmane në luftën kundër mësimi dhe shkrimit shqip nëpër shkollat shqipe. Të tentosh sot ta ndalësh librin, në kohën e kibernetikës dhe teknologjisë informative, është një betejë e humbur si ideja e Don Kishotit me mullinjtë e erës, në kthimin e kohës prapa.

Burgosja e librit dhe moslejimi i përdorimit të librit shqip nëpër shkolla fillore është një shenjë që do një vëzhgim dhe kërkesë që të gjendet një zgjidhje e mundshme e realizimit të drejtave elementare të shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Atje dhe në këtë rajon shqiptarët kanë nevojë për ndihmën tonë, për mbështetjen tonë si Kosovë, si Shqipëri dhe si komb.

Ata kanë nevojë, jo vetëm për libra, ata kanë nevojë për mbështetje që çështjet e tyre të ngrihen në Bruksel në mbrojtjen e të drejtave të patjetërsueshme elementare kombëtare. Ata kanë nevojë për Qeverinë e Kosovës në vendosjen e një reciprociteti ndaj Serbisë në raport me të drejtat e serbëve në Kosovë. Pra, në Luginën e Preshevës ata kanë nevojë që Qeveria e Kosovës t'i vendosë ndaj Serbisë masat e reciprocitetit.

Pra, ato të drejta që i kanë serbët në Kushtetutën e Kosovës t'i kenë edhe shqiptarët në Luginën e Preshevës. Atje është duke u bërë një asimilim modern, me çregjistrim fiktiv, domethënë fshirjen nga evidenca e shqiptarëve nga Medvegja, Bujanoci dhe Presheva. Unë kam marrë një peticion me 7 250 nënshkrime kundër këtij çregjistrimi apo fshirje nga evidenca e banorëve nga shtëpitë e shqiptarëve dhe kjo humbje e shtetësisë tregon asimilimin modern të Serbisë që po e përdor kundër shqiptarëve me ligje diskriminuese apo 'demokratike', siç e thonë ata.

Ne si Komision i takuam edhe dy deputetë shqiptarë në Kuvendin e Serbisë. I takuam dhe biseduam me ta për çështje të arsimit, kulturës dhe politikës. Ata na treguan edhe format e ligjeve që janë diskriminuese në raport me shqiptarët.

Pra, shqiptarët në Luginën e Preshevës kanë nevoja të shumta, por këto nevoja janë më shumë përmbajtësore dhe të domosdoshme për të mbijetuar, atje. Ata kanë nevojë për studime dhe për studentë në universitetet publike të Kosovës pa kuotë, ose pa këtë masë ndëshkuese, por të jenë të barabartë në teste me të gjithë studentët konkurrues shqiptarë të Kosovës.

Ata kanë nevojë për njohjen e diplomave të universiteteve të Kosovës në Serbi. Ata kanë nevojë që Komisioni Evropian dhe Qeveria e Kosovës tashmë në Bruksel ta ngrenë çështjen e SPARK-ut, komision për njohjen e diplomave, të funksionalizohet dhe t'i nostrifikojë këto diploma.

Shqiptarët e Luginës së Preshevës kanë nevojë për ne. Kanë nevojë për mbështetjen tonë. Kanë nevojë për vizitat tona atje. Kanë nevojë për vizitat e zyrtarëve qeveritarë. Kanë nevojë për vizitat e kryeministrit të Kosovës, për vizitat e ministrave dhe të deputetëve. Pra, shqiptarët e Luginës së Preshevës kanë nevojë për mbështetjen e shtetit të Kosovës dhe për shtetin e Kosovës.

Deputeti Nait Hasani paraqiti para Kuvendit propozim-rekomandimet të cilat kërkojmë nga deputetët që të votohen dhe Qeveria e Kosovës t'i zbatojë këto rekomandime.

1. Të bëjmë furnizimin me tekste dhe harta shkollore për shkollat fillore dhe të mesme në Luginë të Preshevës,
2. Të hiqet kuota për regjistrimin e studentëve nga Lugina e Preshevës në universitet publike të Kosovës,
3. Në bisedimet në Bruksel me Republikën e Serbisë të vendosë reciprocitet për çështjet e njëjta në raport me shqiptarët në Luginën e Preshevës dhe komunitetit serb në Kosovë,
4. Të kërkojë nga Republika e Serbisë njohjen e diplomave të lëshuara nga universitet publike të Republikës së Kosovës,
5. Të mbështesë programet për rini për Luginën e Preshevës,

6. Të bëjë funksionalizimin e maternitetit, sepse atje është ndërtuar një maternitet, Shqipëria ka dhënë si shtet 100 mijë euro, Kosova ka dhënë 50 mijë euro, por ai maternitet nuk është funksional për shkak të mungesës së mjekëve. Kërkojmë edhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Qeveria që ta bëjnë atë funksional.

Diskutimi i deputetit Nait Hasani është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Nezir Çoçaj - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Sali Morina - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Ismajl Kurteshi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Valdete Bajraqmi - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, si dhe Labinotë Demi-Murtezi, Shpejtim Bulliqi, Besa Baftiu, Rustem Berisha, Enver Hoti, Emilija Rexhepi, Shaip Muja, Vjosa Osmani, Besa Gaxherri, Ilir Deda, Time Kadrijaj, Shukrije Bytyqi, Raif Qela, Faton Topalli, Daut Haradinaj, Gëzim Kelmendi, Bekim Haxhiu, Albin Kurti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi Xhavit Haliti, hodhi në votim propozim-rekomandimet e paraqitura nga deputeti Nait Hasani, lidhur me gjendjen e arsimit në Luginën e Preshevës.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 63 deputetë.

Kryesuesi konstatoi se për shkak të mungesës së pjesëmarrjes të deputetëve në procedurën e votimit, nuk miratohen Propozim-rekomandimet e paraqitura nga deputeti Nait Hasani lidhur me gjendjen e arsimit në Luginën e Preshevës.

21. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2014

Kryetari njoftoi deputetët se Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2014, e ka shqyrtuar Komisioni Funksional për Buxhet dhe Financa, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Naser Osmani, paraqiti dhe arsyetoi para kuvendit raportin me rekomandime në emër të Komisioni Funksional.

Fjala e deputetëve Naser Osmani është dhënë e plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadëgjona - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Naser Osmani - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Iliri Deda - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Bali Muharremaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Enver Hoti - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Fikrim Danka në emër të Grupit Parlamentar 6+ si dhe Faton Topalli, Fatmir Rexhepi, ministri Avdullah Hoti dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 50,
Kundër----- 9,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2014

22. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2014

Kryetari njoftoi deputetët se raportin vjetor e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2014 e ka shqyrtuar Komisioni Funksional për Buxhet dhe Financa dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Naser Osmani, paraqiti dhe arsyetoi para kuvendit raportin me rekomandime në emër të Komisioni Funksional.

Fjala e deputetëve Naser Osmani është dhënë e plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadëgjona - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Naser Osmani - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Faton Topalli - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Bali Muharremaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Enver Hoti - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Fikrim Danka në emër të Grupit Parlamentar 6+ si dhe, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 52,
Kundër----- 7,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2014.

Në vazhdim, kryetari pas deklarimit të përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe të miratimit nga Kuvendi, deklaroi të mbyllura punimet e seancës për ditën e sotme.

Vazhdimi i saj do të bëhet me datë 14 maj 2015, në ora 10:00.

* * *

14 maj 2015, ora 10:00

Vazhdimi i seancës, e filluar më 6 dhe e vazhduar më 7 e 8 maj 2015

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të seancës plenare të filluar më 6 maj dhe e vazhduar me 7-8 maj 2015.

* * *

Kryetari, para se të fillojë me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, njoftoi Kuvendin me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për zëvendësimin e deputetit Sergjan Popoviç në vend të ish-deputetit të ndjerë Velimir Rakiq, nga radhët e Grupit Parlamentar Lista serbe.

Kryetari i dëshiroi mirëseardhje deputetit të ri dhe e ftoi atë që ta nënshkruajnë tekstin e betimit.

Më pas deputeti i lartpërmendur e nënshkroi tekstin e betimit.

* * *

Në vazhdim, lidhur me rendin e ditës, për fjalë u paraqit deputeti: Glauk Konjufca.

Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, propozoi që në rendin e ditës të seancës së sotme të shqyrtohet çështja lidhur me zhvillimin e ngjarjeve të fundit në Kumanovë-Maqedoni.

Fjala e deputetit, Glauk Konjufca, është dhënë e plotë në transkript.

Në lidhje me propozimet e Glauk Konjufcës, kryetari kërkoi deklaratimet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Në lidhje me propozimin e deputetit Glauk Konjufca u deklaruan deputetët: Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Donika Kadaj-Bujupi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zafir Berisha - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Myfera Shinik - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Sasha Milosavljeviç në emër të Grupit Parlamentar Lista Serbe, diskutimet e cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryetari, hodhi në votim, propozimin e paraqitur nga deputeti: Glauk Konjufca.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----28,
Kundër ----- 50
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e nuk miratoi propozimin e deputetit Glauk Konjufca.

23. Shqyrtimi i raportit të auditimit për vitin 2013 të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kryetari, ftoi Zëvendës Auditorin e Përgjithshëm, z. Artan Venhari, për paraqitjen e raportit.

Artan Venhari tha se ky raport është bazë për të ofruar ose për të kërkuar transparencë, llogaridhënie dhe vlerën për para nga organizatat buxhetore dhe nga Qeveria, nga shpenzuesit e parasë publike. Dhe, këtë ia propozon Kuvendit, do të thotë Kuvendi kërkon nga organizatat buxhetore, nga shpenzuesit llogaridhënie se si i kanë shpenzuar paranë publike, transparencën për mënyrën, mirëpo edhe rezultatet e arritura me shpenzimin e asaj paraje publike, do të thotë fondit të Kosovës.

Një pyetje, të cilën e kemi pasur gjatë kohës së hartimit të kësaj është se a janë informatat, të cilat janë në pasqyrat vjetore financiare të nxjerra nga Qeveria e Kosovës, nëse këto janë të besueshme edhe përgjigjja jonë ka qenë që po - këto janë të besueshme edhe për këtë arsye raporti është i pamodifikuar, do të thotë nuk ka modifikim.

Mirëpo, do të cek njëkohësisht se ka theksim të çështjes edhe theksimi i çështjes është për njërën nga dobësitë, të cilat janë hasur ato, e ajo ka të bëjë me mënyrën e trajtimit dhe raportimit të pasurive nga organizatat buxhetore, do të thotë, nga të gjitha nivelet. Sa i përket raporteve vjetore të auditimit duhet të them se në vitin 2012 kanë qenë 10 rekomandime, nuk jemi të kënaqur me mënyrën se sa janë adresuar ato, nga 10 prej sosh 2 janë adresuar në tërësi, 2 pjesërisht, ndërsa 6 nuk janë adresuar aspak.

Në këtë vit, do të thotë për vitin 2013, kemi dhënë 8 rekomandime, edhe tash mbetet në gusht të këtij viti kur të dorëzojmë raportin vjetor të ardhshëm të auditimit, të shohim se cila është performansa lidhur me adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra e Auditorit. Dhe, tani jemi në atë proces që jemi duke i përcjell të gjitha rekomandimet, të cilat i kemi dhënë më herët se si po adresohen ato, do të thotë, edhe të vitit paraprak edhe të këtij viti.

Për të nxjerr për këtë përfundim do të thotë që është raport i pamodifikuar me theksim të çështjes, ne kemi bërë 102 auditime, auditime të rregullsisë, të performansës, mirëpo edhe të fondeve të donatorëve se si janë menaxhuar ato. Çështjet që kanë që kanë apo kërkojnë një trajtim të veçantë edhe nga Qeveria, do të thotë edhe Kuvendi që të tërheqë vëmendjen drejt Qeverisë se ku duhet të fokusohen, janë mënyra se si po trajtohet pasuria në vazhdimësi, për shkak se në vazhdimësi kemi nënvlerësim të pasurisë edhe shifra jonë ceket që diku rreth mbi 135 milionë është nënvlerësimi i pasurisë.

Do të thotë, thjesht nuk është raportim apo trajtim i duhur i kësaj çështje e cila vazhdon nga viti në vit të na përcjell. Kemi mangësi, të cilat janë shfaqur shumë në proceset e prokurimit edhe duke dëgjuar debatin e Kuvendit edhe javën e kaluar, pash që edhe vetë Qeveria përmendi disa nga hapat, të cilët edhe ne kemi kërkuar nga ta, e ata kanë të bëjnë me rritjen e transparencës, hapjen e procesit apo fillimin e procesit të E prokurimit, do të thotë të jetë elektronik.

Rritja e obligimeve nga viti në vit është mjaft alarmante për shkak se nëse shikojmë vetëm prej vitit 2013, në vitin 2014, rritja e obligimeve nga organizatat buxhetore ka qenë, ka rritje të 100%, do të thotë është dyfishuar kjo vlerë edhe kjo do trajtim të menjëhershëm nga Qeveria. Presim që në fillim që deri në raportin e ardhshëm të shikojmë se si është performansa e kësaj se si do të trajtohet. I njëjti, problem të cilin e kemi hasur, të cilin e kemi prezantuar edhe në raportin tonë vjetor të auditimit, ka qenë edhe pagesat nga palët e treta,

mirëpo mund të them se në diskutim me Ministrinë e Financave, me ministrin, ka filluar të trajtohet dhe kërkesa nga ministri është bërë tek të gjitha organizatat buxhetore që t'i prezantojnë edhe pagesat nga palët e treta, të cilat informata tani do t'i marrim gjatë procesit të auditimit.

Një tjetër problem të cilin e kemi hasur edhe i cili është diskutuar në këtë seancë ishte edhe trajtimi i borxheve nga KEK-u, do të thotë, ka borxhe- KEK-u ka marrë hua nga Qeveria e Kosovës, nga buxheti i Kosovës, mirëpo ajo nuk është duke u trajtuar. Duhet të kërkohej llogari, duhet të kërkohej nga KEK-u që të fillojë edhe pagesa e atyre borxheve. Do të thotë, duhet të kërkojmë më shumë llogari lidhur me fondet apo financat, shpenzimet që janë duke ndodhur.

Fjala e plotë e z. Venhari është dhënë në transkript.

Deputeti Besnik Bislimi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike, paraqiti dhe arsyetoi para kuvendit raportin me rekomandime.

Fjala e plotë e deputetit Besnik Bislimi është dhënë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Hajdar Beqa - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Synavere Rysa - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Besnik Bislimi - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Bali Muharremaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Enver Hoti - në emër të Grupit Parlamentar NISMA si dhe Fatmir Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi Sabri Hamiti, hodhi në votim, rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me Raportin vjetor të Auditimit për vitin 2013 të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----62,
Kundër ----- 1
Abstenime ----- 2

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

Miratohen rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2013 të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Në vazhdim, kryesuesi Sabri Hamiti procedoi me pikat si në vijim:

18. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin e qytetarëve të Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit

Kryesuesi Sabri Hamiti tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e mbajtur me 7 maj 2015.

Më pas ai e ftoi Lirije Kajtazin, kryetare e Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, për paraqitjen dhe arsyetimin e

propozim-rekomandimeve lidhur me këtë çështje.

Lirije Kajtazi tha se propozim-rekomandimet e komisionit që ajo udhëheq janë të njëjta me ato të cilat i kemi paraqitur në raportin e komisionit funksional.

Këto propozim-rekomandime mund të rishikohen edhe njëherë nga ana e përfaqësuesve e grupeve parlamentare, nëse për këtë tregohet interesim, tha ajo.

Diskutimi i deputetes Lirije Kajtazi është dhënë i plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Glauk Konjufca, Lirije Kajtazi, Teuta Haxhiu dhe Mytaher Haskuka, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 49 deputetë.

Kryesuesi, më pas konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

24. Shqyrtimi i raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2014

Kryesuesi Sabri Hamiti i njoftoi deputetët se raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2014 e ka shqyrtuar Komisioni Funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, e ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2014, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Zenun Pajaziti, paraqiti dhe arsyetoi para kuvendit raportin me rekomandime në emër të Komisioni Funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

Ndërsa deputeti Naser Osmani paraqiti dhe arsyetoi para kuvendit raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Fjala e deputetëve Zenun Pajaziti dhe Naser Osmani është dhënë e plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Xhevahire Izmaqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sadri Ferati - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Shqipe Pantina - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Pal Lekaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Enver Hoti - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, si dhe Bekim Haxhiu, Milazim Haliti dhe Teuta Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 55,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2014

25. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014

Kryesuesi Sabri Hamiti i njoftoi deputetët se raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014, e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, e ka shqyrtuar raportin financiar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Deputetja Albulena Haxhiu, paraqiti dhe arsyetoi para kuvendit raportin me rekomandime në emër të Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit.

Ndërsa deputeti Naser Osmani paraqiti dhe arsyetoi para kuvendit raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Fjala e deputetëve, Albulena Haxhiu dhe Naser Osmani është dhënë e plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Agim Aliu - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Agim Ademi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Donika Kadaj-Bujupi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Shukrije Bytyqi - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e raportit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 62,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014.

26. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2014

Kryesuesi Sabri Hamiti, njoftoi deputetët se Raportin e Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2014, e ka shqyrtuar Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, e ka shqyrtuar Raportin Financiar të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2014, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Muhamet Mustafa, paraqiti dhe arsyetoi para kuvendit raportin me rekomandime në emër Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Ndërsa deputeti Naser Osmani paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Fjala e deputetëve, Muhamet Mustafa dhe Naser Osmani është dhënë e plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Blerim Grainca - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Pal Lekaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Enver hoti - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, si dhe Fatmir Rexhepi dhe Ali Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 15,
Kundër----- 43,
Abstenime----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Nuk miratohet raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2014.

Kryesuesi Sabri Hamiti, në vazhdim procedoi me pikën me nr.19 të rendit të ditës.

19. Rekomandimet e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me Peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike

Kryesuesi Sabri Hamiti tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e mbajtur me 8 maj 2015.

Në lidhje me këtë çështje diskutuan deputët Glauk Konjufca dhe Teuta Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi, për shkak të mungesës së kuorumi,t nuk procedoi me votim këtë pikë të rendit të ditës.

27. Shqyrtimi i raportit financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014

Kryesuesi Sabri Hamiti ftoi përfaqësuesin e Qeverisë për paraqitjen e këtij raport. Ministri Arban Abrashi e paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit raportin financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Fjala e ministrit Arban Abrashi është dhënë e plotë në transkript.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se raportin financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Naser Osmani, paraqiti dhe arsyetoi para kuvendit raportin me rekomandime në emër Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa.

Fjala e deputetit Naser Osmani është dhënë e plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Naser Osmani - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Besnik Bislimi - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Bali Muharremaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Enver Hoti - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, si dhe Fatmir Rexhepi dhe Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 43,
Kundër----- 18,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

28. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social

Kryetari i njoftoi deputetët për raportin me rekomandimet të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social.

Deputetja Time Kadrijaj, në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social.

Ajo paraqiti para Kuvendit një nga një rekomandimet e Komisionit Funkcional.

Diskutimi i deputetes Time Kadrijaj është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fadil Beka - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hatim Baxhaku - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Besa Baftiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Shukrije Bytyqi - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, si dhe përfaqësuesi i Qeverisë Ministri Arban Abrashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim Raportin me rekomandime të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 66,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social.

29. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Investimet e huaja

Kryetari i njoftoi deputetët për Raportin me rekomandimet të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Investimet e huaja.

Deputeti Besim Beqaj, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Investimet e huaja.

Ai paraqiti para Kuvendit një nga një rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Diskutimi i deputetit Besim Beqaj është dhënë i plotë ne transkript.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Besim Beqaj - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Blerim Grainca - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Enver Hoti - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Fikrim Danka në emër të Grupit Parlamentar 6+, si dhe Sala Berisha-Shala, Margarita Kadriu-Ukelli dhe ministria Hykmete Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim Raportin me rekomandimet të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Investimet e huaja.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 66,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Raportin me rekomandimet të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Investimet e huaja.

20. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e arsimit në Luginë të Preshevës, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, mbështetur edhe nga gjashtë (6) deputetë tjerë

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e mbajtur me 8 maj 2015.

Ai ftoi deputetin Nait Hasani që në emër të propozuesit të çështjes të paraqet para Kuvendit rekomandimet e propozuara, lidhur me këtë çështje.

Nait Hasani i paraqiti para Kuvendit një nga një rekomandimet e propozuara.

Fjala e z. Nait Hasani është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim rekomandimet e propozuara nga deputeti Nait Hasani.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nxori këto:

REKOMANDIME

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, obligohet të bëjë furnizimin me tekste dhe harta shkollore për shkollat fillore dhe të mesme në Luginë të Preshevës.
2. Të hiqet kuota për regjistrimin e Studentëve nga Lugina e Preshevës në Universitetet Publike në Kosovë.
3. Republika e Kosovës me Serbinë të vendosë reciprocitet për çështjet e njëjta në raport me shqiptarët në Luginën e Preshevës dhe komunitetit serb në Kosovë.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë nga Republika e Serbisë njohjen e diplomave të lëshuara nga Universitetet Publike të Republikës së Kosovës.
5. Të mbështeten programet për rini për Luginë të Preshevës.
6. Të bëhet funksionalizimi i maternitetit.
7. Të zbatohet Rezoluta e miratuar në Kuvendin e Kosovës me 6 qershor 2013 për Luginën e Preshevës.

30. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kërkoi nga grupet parlamentare që të propozojnë kryetarin, zëvendëskryetarët dhe anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

Pas paraqitjes së propozimeve nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, kryetari i hodhi në votim propozimet për kryetarin, zëvendëskryetarët dhe anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 65,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

VENDIM

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga radha e komunitetit Serb, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaqi, nga GP i PDK-së, kryesuese,
2. Jelena Bontiq, nga GP LS-së, zv/kryesuese e parë,
3. Pal Lekaj, nga GP AAK, zv/kryesues i dytë,
4. Zenun Pajaziti, nga GP i PDK-së, anëtar,
5. Sadri Ferati, nga GP i LDK-së, anëtar,
6. Bardhyl Metaj, nga GP i LDK-së, anëtar,
7. Shqipe Pantina, nga GP i VV-së, anëtare,
8. Zafir Berisha, nga GP Nisma për Kosovën, anëtar,
9. Qerim Bajrami, nga GP “6+”, anëtar.

II. Ngarkohet Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga radha e komunitetit serb, që të veprojnë në përputhje me nenin 6 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 17:05 minuta.

*Përgatiti: Selman Ymeri,
zyrtar i lartë ligjor*

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI